

VENDIM
Nr.57, datë 4.11.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Hilmi Dakli, Anëtar i “““

Zija Vuci, Anëtar i “““

Franc Jakova, Anëtar i “““

Hajredin Fuga, Anëtar i “““

Alfred Karamuço, Anëtar i “““

Kujtim Puto, Anëtar i “““

Kristofor Peçi, Anëtar i “““

Sokol Sadushi, Anëtar i “““

me sekretare Arta Palushi, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura më datë 14.09.1998 çështjen nr.43 Akti që u përket:

K Ë R K U E S:

1. HASAN LAÇAJ

2. KOMUNITETI MYSLIMAN SHQIPTAR

3. KISHA ORTODOKSE, të përfaqësuar nga avokatët Dilaver Rexhepi e Nexhdet Kambo.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SHOQËRIA TREGTARE “ROZAFAT” SHKODËR, në mungesë.

2. AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT, në mungesë.

OBJEKTI:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.927, datë 04.06.1998 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesit kanë parashtruar pranë Gjykatës Kushtetuese si shkak për antikushtetutshmërinë e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit, moszbatimin nga ky kolegji të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 10.04.1998, i cili në bazë të Dispozitave Kryesore Kushtetuese është përfundimtar dhe i formës së prerë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të kërkuesve, shpjegimet e subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit në dhomën e këshillimit më datë 4.6.1998 kanë vendosur mospranimin për shqyrtim të çështjes së dërguar nga Gjykata Kushtetuese, me arsyetimin se vendimet e Gjykatës së Kasacionit nuk mund të cënohen nga asnjë instancë apo organ tjetër dhe nuk mund të investohet asnjë organ gjyqësor për shqyrtimin e çështjeve nga Gjykata Kushtetuese.

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit duhet të shpallet antikushtetues.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit me vendimin që kanë dhënë, konfundojnë dhe nuk dallojnë kontrollin kasacional nga kontrolli kushtetues. Neni 6/1 i ligjit

nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, vërtet shpreh në thelb pavarësinë vendimore të pushtetit gjyqësor, por kjo nuk duhet parë e shkëputur nga Dispozitat Kryesore Kushtetuese në tërësi, dhe nga e drejta e Gjykatës Kushtetuese, që si autoriteti më i lartë që mbron dhe garanton respektimin e kushtetutes, ushtron kontrollin kushtetues mbi të gjitha aktet që çënojnë të drejtat themelore të shtetasve, qofshin akte të organeve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv apo gjyqësor. Në këtë aspekt, nuk përjashtohen as vendimet e Gjykatës së Kasacionit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit padrejtësisht kanë tejkaluar kompetencat e tyre duke marrë atributet e interpretimit të dispozitave kushtetuese. Ky organ me interpretimin që i ka bërë nenit 24, pika 9 të ligjit Kushtetues, jo vetëm që ka hyrë padrejtësisht në kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, i cili është i vetmi organ që interpreton Kushtetutën dhe ligjet kushtetuese, por njëkohësisht e ka interpretuar gabim këtë dispozitë kushtetuese. Dispozita e sipërcituar që i jep të drejtë Gjykatës Kushtetuese të zgjidh përfundimisht ankesat e personave të paraqitur në rrugën e kontrollit kushtetues, për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjëshme, nuk ka kuptimin që i japin Kolegjet e Bashkuara sipas të cilëve, Gjykata Kushtetuese duhet të zgjidh përfundimisht çështjen konkrete, duke i hyrë dhe themelit të saj. Gjykata Kushtetuese zgjidh përfundimisht kushtetutshmërinë e akteve të paligjëshme që çënojnë të drejtat themelore të shtetasve, që përbën dhe aspektin kryesor të kontrollit kushtetues që ka kjo gjykatë, duke mos cënuar aspak të drejtën që kanë gjykatat e zakonëshme, që të zgjidhin vet në themel çështjet konkrete në rrugën normale të shqyrtimit të saj.

Sipas nenit 26, paragrafi 2 i ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të formës së prerë.

Zbatimi i këtyre vendimeve është një detyrim kushtetues, dhe nuk ka të drejtë asnjë organ që të vërë në diskutim vlefshmërinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara sipas të cilit është vendosur mospranimi i çështjes për shqyrtim, kur detyrimi për ta zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese buron nga Dispozitat Kryesore Kushtetuese, përbën një precedent të gabuar që vë në diskutim kredibilitetin e Gjykatës së Kasacionit, e cila me këtë vendim antikushtetues që ka marrë, bëhet përgjegjëse për konfliktin institucional që mundet të krijojë artificialisht.

Edhe nga pikëpamja formale juridike ky vendim i Kolegjeve të Bashkuara ka një inkoherencë arsyetimi, sepse megjithëse çështjen e ka shqyrtuar në dhomën e këshillimit, ato kanë dëgjuar relacionin dhe pretendimet e palëve; çështja megjithëse është shqyrtuar duke arsyetuar dhe vendimin, Kolegjet e Bashkuara shprehen për mospranimin e çështjes për shqyrtim, duke iu referuar padrejtësisht nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile, i cili nuk e parashikon të drejtën e gjykatës për të vendosur në këtë mënyrë.

Në këto kushte vendimi nr.927, datë 04.06.1998 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit është antikushtetues dhe në bazë të nenit 45 të ligjit nr.8373, datë 15.07.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” nuk sjell asnjë efekt juridik.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, dhe të nenit 41 të ligjit nr 8373, datë 15.07.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, njëzëri,

VENDOSI:

Shpalljen antikushtetues të vendimit nr.927, datë 04.06.1998 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.